



Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 7842/2024
Data: 18.09.2024

PROCESVERBAL I KOMITETIT PER KOMUNITET

Nga mbledhja e tetë -VIII-për vitin 2024 i Komitetit për Komunitete, mbajtur me datë: 28.08.2024 me fillim pune në ora 14:00 në sallën e takimeve. Prezent ishte zyrtari i Arkivës dhe Transparencë z.Bashkim Sopa.

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Takim me Zyrtarin e Zyrës për Informim dhe transparencë.
3. Takim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë.
4. Eventuale .

U MIRATUA RENDI I PUNËS

1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin; nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. Takim me Zyrтарin e Zyrës për Informim dhe transparencë.

Kryesuesi thekson: për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Resul Suma thekson: kërkoj nga zyrtari në fjalë që të na njofton për përgjegjësitë e tij të cilat i ka.

Bashkim Sopa thekson: me akt emërim jam zyrtarë i arkivës dhe transparencës por me vendim shtesë jam edhe zyrtarë për qasje në dokumente zyrtare. Ajo qa na intereson neve është raporti vjetorë i MAPL-së të cilin e marrim për çdo vit që monitorohen aktet e komunës , aktivitetet e komunës për 2023 të cilën e kemi pranuar në fund të muajit mars për vitin 2023 . Prej tridhjetë e tetë (38) indikatorëve të cilët janë obligative tridhjetë e shtatë (37) indikatorë i kemi plotësuar . Raport tjetër i pavarur është raporti i KDI-së i cili ka dalë i mirë që prej 100 % të indikatorëve 92.5 % i kemi plotësuar, mirëpo ajo që është më kryesore është sistemi i monitorimit të performancës është një sistem që e ka instaluar Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal i cili është me 121 indikatorë dhe me mbi 500 pyetje dhe 14 fusha e që një prej atyre fushave është edhe transparenca e komunave dhe aty jemi me 81.8 % që do të thotë jemi prej komunave në nivel mbi mesataren e Kosovës që do të thotë se në bazë të këtyre raporteve ne qëndrojmë mirë nuk jemi keq e asaj i shtohen puna e kuvendit, komiteteve , transmetimet e seancave të cilat janë pjesë që monitorohen në vazhdimësi , publikimi i procesverbaleve të mbledhjeve të kuvendit, publikimi i vendimeve të kuvendit janë indikatorë që monitorohen gjatë tërë vitit.

Kryesuesi thekson: a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk keni kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

3. Takim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë.

Kryesuesi thekson: njoftimi i është bërë me kohë por pasi që nuk është prezent askush nga kjo drejtori kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

4.Eventuale

Kryesuesi thekson: për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Resul Suma thekson: çështja e qenve endacak është problem por do ta diskutojë në kuvend si problem.

Kryesuesi thekson: a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk keni shpalli të mbyllur mbledhjen.

Mbledhja përfundoi në 14:37.

Procesmbajtësi

Ayni Bushi

